

Federazione Associazioni Arbëreshe – Federata e Shoqatave Arbëreshe

Piazza della Repubblica 9/a, 87019 Spezzano A. – tel. 3388700823; mail presidente.faa@gmail.com

12 shtator 2020

Përse duhet të mbështesim QSPA

(QENDRA E STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT)

Letër e hapur drejtuar:

Kryetarëve të komunave arbëreshe në Itali

Shoqatave dhe fondacioneve arbëreshe,

Personaliteteve dhe veprimtarëve kulturorë arbëreshë

Prillin e kaluar u inagurua *QSPA (Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët)*, e miratuar në shtatorin e vitit 2019 nga ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko.

Nën drejtimin e institucionit u emërua, docentja universitare e italianistikës, e njohur dhe e vlerësuar, bija e prof. Jup Kastratit, një nga studiuesit më të rëndësishëm të Jeronim de Radës dhe të letërsisë arbëreshe.

QSPA si institucion ka si qëllim studimin dhe vlerësimin e komuniteteve arbëreshe në Itali e Kroaci.

Qeveria shqiptare, me Kryeministrin Z. Edi Rama, përmes ministrit të Shteti për Diasporën, arriti kështu të shuante pas tridhjetë vjetësh boshllëkun e krijuar ndaj interesit të italo-shqiptarëve, i mbartur si pasojë e ndryshimit të sistemit politik, nga një sistem i modelit komunist në një sistem të modelit demokratik të tregut të lirë.

Vështirësia e riorganizimit të shtetit dhe të ekonomisë shqiptare, e shoqëruar me çështje të thella si eksodi biblik i qindra e mijërave Shqiptarëve, veçanërisht në Itali dhe në Greqi, shkaktoi humbjen e fokusit të qeverive shqiptare që të krijonte politika interesi dhe mbështetjeje për komunitetet arbëreshe në territorin tonë kombëtar, pavarësisht se gjatë tridhjetë viteve të fundit midis qeverive shqiptare e atyre italiane kanë vazhduar të konsolidohen politika bilaterale, veçanërisht në bashkëpunime kulturore.

Ndërkohë, përgjatë këtyre viteve të një modeli shtetëror ndryshe, në Shqipëri u pakësuan personalitetet dhe studiuesit e albanologjisë, të cilët në gjysmën e parë të shekullit të kaluar kishin ndihmuar Arbëreshët të ndërjegjësoheshin për fuqinë e jashtëzakonshme të vetë trashëgimisë sonë historike- kulturore. Praktikisht, nga viti 1993, kemi mbetur jetim të trurit që na mësonin se çfarë duhej të bënim, ashtu si dhe të materialeve të shtypit dhe të librave që vinin nga institucione të ndryshme nga Shqipëria.

Krijimi i *Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët* ndërthuret ndër të tjera me dy fenomene, kontradiktore në vetvete, por që sidoqoftë, kanë si protagonistë Arbëreshët. Në Shqipëri, si në të gjithë Diasporën Shqiptare nëpër botë, falë edhe teknologjive të reja të

komunikimit digjital, është ngjallur një interes për "vëllezërit arbëreshë" që kanë jetuar në Itali ose në shtete të tjera të Ballkanit për gati rreth gjashtëqind vjet.

Në të njëjtën kohë ne përballemi në mënyrë dramatike me mospërdorimin e gjuhës shqipe tek brezat e rinj, veçanërisht në nivel shkollor, ku nuk ka politika mbrojtëse dhe ku përzierja e mësuesve të gjuhës italiane, regjistrimet e nxënësve të shkollës vetëm në italisht dhe fëmijëve që vijnë nga familje dygjuhëshe po shkakton gjenocid gjuhësor, gjë për të cilën gjithmonë e kemi pasur frikë.

Shpresat tona për mbijetesë dhe vazhdimësi gjuhësore mund të gjejnë tek QSPA atë vendndodhje të përbashkët për të ruajtur të gjithë trashëgiminë tonë, dhe, prej andej, të gjithë së bashku, të gjejmë mënyrat për shpëtimin dhe rigjenerimin e trashëgimisë sonë gjuhësore, historike dhe identitare.

Për këtë, falënderimet tona të sinqerta i drejtohen Ministrit, Z. Pandeli Majko, i cili krijoi QSPA dhe kreut të qeverisë shqiptare, Z. Edi Rama, i cili mbështeti krijimin e saj.

Tani që ka lindur QSPA dhe gjithçka duhet të bëhet për ta bërë atë të rritet dhe bëhet më e fortë dhe e qëndrueshme.

Si të gjitha krijesat e sapolindura, QSPA është e brishtë dhe rrezikon të thërrmohet përballë vështirësive dhe kontrasteve (në Itali e në Shqipëri) që, sigurisht, do të manifestohen për të limituar zhvillim e saj, duke shfrytëzuar mbi të gjitha dobësinë e krijuar gjatë këtyre 25 viteve mungesë të politikave pro-arbëreshe.

Ne si FAA, pa nëse se dhe pa por, e mirëpritëm me entuziazëm fillimin e aktiviteteve të Qendrës dhe udhëzimet e shprehura nga Drejtoresha Diana Kastrati. Në veçanti, ne e vlerësuam punën e saj horizontale dhe ndihmëse me institucionet e tjera shqiptare mbi këtë temë. Protokollet e bashkëpunimit me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, me universitetet italiane të pellgut italian të Adriatikut, vullneti për të bashkëpunuar me universitetet e Shqipërisë dhe të Kosovës e më gjerë, janë pika të bashkëpunimit të gjerë shkencor, por edhe politik nëse ky term mund përshtatet në këtë kontekst.

Ne gjithashtu vlerësuam dhe gatishmërinë për t'u takuar me kryetarët e bashkive arbëreshe të Italisë dhe botës së shoqatave, të shpallur nga Prof. D. Kastrati, e cila do të kishte ardhur tashmë midis nesh për të ilustruar mendimet dhe propozimet e saj, nëse masat e kontrollit të Covid-19 nuk do ta kishin parandaluar. Ky problem shëndetësor bëri që ky Kuvend i parë Ndërkombëtar për Arbëreshët, i planifikuar të nga QSPA që të zhvillohej më 16 dhe 17 shtator, me një shtojcë gjithashtu më 18 shtator, të shtyhej për datat 25 dhe 26 nëntor 2020.

Në këto muaj kontaktesh ne kemi bashkëpunuar sinqerisht dhe pa interesa të veçanta me Drejtoreshën Kastrati dhe me disa nga bashkëpunëtorët e saj, duke shkëmbyer informacione dhe sugjerime, si edhe materiale. Në fund, në mënyrë spontane, lindi ideja e nënshkrimit të një protokollit bashkëpunimi midis FAA dhe QSPA, të cilin ne e nënshkruam në gusht dhe që na mbush me krenari.

Tani është koha për të punuar për të fuqizuar QSPA-në. Idetë dhe propozimet janë të shumta, dhe do të kemi kohë për t'i treguar.

Por ka një çështje urgjente nga e cila duhet nisur sa më shpejt: të furnizojmë Bibliotekën dhe Arkivin e QSPA-së me material dokumentar që i shërben Drejtoreshës Kastrati dhe bashkëpunëtorëve të saj për të vënë në vijë programin e Qendrës.

Sipas mendimit tonë, QSPA duhet të pasurohet me materiale, libra, me revista dhe dokumente që sigurisht nuk i kanë. Ne jemi në gjendje për të plotësuar këtë boshllëk në një masë të madhe. Mund ta bëjmë si një Federatë e thjeshtë, por do të dëshironim ta bënim së bashku me shumë miq të tjerë arbëreshë për të dhënë një sinjal të fortë për ta mbështetur këtë projekt.

Në këtë kuptim kemi nisur një fushatë për të mbledhur libra dhe gazeta deri më 25 nëntor, ditën kur shpresojmë të jemi në gjendje të shkojmë në Tiranë. Gjithashtu kemi vendosur në Bordin tonë të fundit t'i sigurojmë QSPA-së një fond prej të paktën 5000 fotografish nga epoka paradigjiale, si dhe të mbledhim materiale fonike, audiovizive dhe filmike.

Dhe ky është vetëm hapi i parë i nënshkruar midis FAA dhe QSPA. Natyrisht, nuk kërkon të jetë gjithëpërfshirës me çdo kusht, ashtu si edhe ne nuk mendojmë për përjashtimin e detyruar të subjekteve të tjerë që nuk e njohin veten në FAA.

Të gjithë mund të ndërmarrin veprime përmes nesh, dhe ne do të sigurojmë që edhe dhurimi më i vogël të regjistrohet në mënyrë korrekte gjatë gjithë rrugëtimit të tij: nga dhuruesi te marrësi. Por, nëse dikush synon ta bëjë atë në mënyrë të pavarur, natyrisht, do të ketë bekimin dhe bashkëpunimin tonë aktiv.

E rëndësishme është që të jemi të shumtë në kontributin e dhurimin ndaj Qendrës me materiale të cilat s'mund t'i ofrojë askush tjetër, përveçse nesh. Për këtë arsye, në fund të letrës janë vendosur adresa e numra telefoni me të cilat mund të hyni në kontakt.

Në përmbyllje, ne u nisëm me entuziazmin sepse mendojmë se jemi një burim dhe një rast sa unik, aq dhe i rrallë për shpëtimin e trashëgimisë sonë. Për këtë i kërkojmë kryetarëve të bashkive, shoqatave kulturore, fondacioneve, institucioneve akademike dhe shkencore, individëve italo-shqiptarë t'i bashkohen me një forcë për një mbështetje kolegjiale, për Institutin e Tiranës që duam ta quajmë *FORUMI i Arbëreshëve për QSPA*.

Gjithashtu, duket se propozimi ynë për ndërtimin e një Shtëpie të Arbëreshëve në Shqipëri vijon me kujdes. Reagimet e para entuziaste u ndoqën nga disa heshtje të pashpjegueshme, të cilat nuk arrinim t'i kuptonim. Lajmet e muajve të fundit na japin shpresë.

FAA, pa **NËSE SE** dhe pa **POR**, ka vendosur të mbështesë këtë projekt që në fillim, me forcën e ndërgjegjes sonë identitare për të vlerësuar edhe Kalabrinë ku kemi lindur e ku jetojnë më shumë se gjashtëdhjetë për qind e kulturës arbëreshe, dhe të mbajmë qëndrim të drejtë me shtetin italian ku ne jemi qytetarë e që njihemi nga ligji respektiv.

Duke ju falënderuar për leximin e durimin, ju përcjell përshëndetjet e mia më të sinqerta.

Damiano Guagliardi (President i FAA)

P.S. Informacione të vlefshme:

Adresa: **Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët**, Rruga Ibrahim Rugova, nr 5, Pall. Sky Tower, kat 7, ap. 4, Tirana 1001, Albania.

www.qspa.gov.al/kontakt; e-mail: info@qspa.gov.al

Drejtoresha: Prof. Diana Kastrati, tel. 00355 692055082, e-mail: Diana.Kastrati@qspa.gov.al